REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES**
**KESHILLI BASHKIAK**

# VENDIM

**Nr. 69, datë 26. 11 .2020**

**Për rinovimin e kontratës se dhënies me qira të fondit pyjor për antene të telefonisë celulare në ngastrën 118b,Ek.Pyjore Shllak 2, subjektit "ALBtelekom" sh. a.**

Këshillit Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës 26 . 11 .2020,me propozim të kryetarit të bashkise mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja "e(l)",neni 18 pika 2 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore* nenin 25 e ligjit nr. 57/2020 date 30.04.2020 "*Për Pyjet*" pika **49** e VKM nr. 433 datë 08.06.2016 i ndryshuar "*Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotava publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive*" ; pika nr 2 germa (a),pika 7 e Udhëzimit nr. 1 datë 09.06.2016 "*Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik*" i propozojme Këshillit të Bashkise Vau-Dejes.

**VENDOSI**

**1**. Rinovimin e kontratës nr.KK1011 SA,Datë 22.07.2011për dhënie me qira te fondit Pyjor për ngastrën nr .118b Ekonomia pyjore shllak 2 ,me siperfaqe **0.02 ha** për antene për kumunikime elektronike,publike,telefoni celulare, si dhe rrugë kalimi me gjatësi 0.2 km nga Subjektit **"ALBtelekom" sh a**

**2.** Afati i rinovimit të kontrates të jetë **1 ( nje ) vit**

**2.** Efektet: Jep impaktë pozitive tek komuniteti duke rigjeneruar te ardhura , sigurohen të ardhura tek Bashkia të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.

**3.** Vlera e dhënies me qira vjetore të jete sipas studimit tekniko-ekonomik bashkëlidhur, sipas VKM nr. 1064, dt. 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave".

**4.** Ngarkohen Drejtoria e Zhvillimit Rural dhe Turizmit për zbatimin e ketij vendimi.

**5.** Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

ZV. **KRYETAR**
Ervis Shimaj

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Adrian Çeleprifi

Miratuar me 19 vota
Vota Pro 19
Vota Kunder —
Vota Abstenim —
Zbardhur me datë 02.12.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E PYJEVE ,TURIZMIT,KULTURES DHE MJEDISIT

**Nr.**6119 **Prot.** **Vau Dejës, me** 16 / 10 **2019**

**Lenda:** Dërgim projekt Vendimi

**KËSHILLIT TË BASHKISË**
**VAU DEJËS**

Në zbatim të detyrimeve që dalin nga ligji Nr.139/2015"Për vetqeverisjen Vendore",ligjit **57/2020 dt 30.04.2020 "Për pyjet" neni 25**,bashkëlidhur po ju dergojmë projekt vendimin"për miratimin rinovimit **të kontratës së dhënies me qira të fondit pyjor për Antenë të telefonisë celulare në objektin Gushte,ngastra nr.118c,ekonomia Pyjore Shllak 2 ,subjektit "Albtelecom"Sh.a**

**Bashkelidhur projekt vendimit jepen:**

- Raporti tekinik dhe Relacioni i hartuar nga Sektori ë Administrimit të pyjeve e Kullotave nr.3,Prot.date 15.01.2020
- Kërkesa e subjektit nr.3810/1,datë 16.07.2020"Kërkesë për lidhje kontrate qiraje"
- Kopje e kontratës datë 22.07.2011 me afat deri me 01.06.2020 e lidhur ndërmjet ish komunes temal dhe subjektit **"Albtelecom"Sh.a** me afat 5 vjeçar.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

**KRYETARI**
**MARK BABANI**

**NË MUNGESE DHE ME URDHËR**
**ZV/ KRYETARI**
**KRISTIAN SHKRELI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU I DEJËS

*Adresa: Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës, Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail: info@vudejes.gov.al*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES**
**DREJTORIA E ZHVILLIMIT RURAL DHE TURIZMIT**
**Sektori i Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave**

Nr._92_prot. Vau Dejës, më 16.10.2020

**PROJEKT V E N D I M**

**Nr. 17, datë 16.10.2020**

**Për miratimin e rinovimit të kontratës se dhënies me qira të fondit pyjor për antene të telefonisë celulare në ngastrën 118b,Ek.Pyjore Shllak 2, subjektit "ALBtelekom" sh. a.**

Me propozim të Kryetarit së Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja "el", të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore neni 25 pika 1 e ligjit nr. 57/2020, dat, 30.04.2020 "*Për Pyjet*" , **pika 49** e VKM nr. 433 datë 08.06.2016,i ndryshuar "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive",i ndryshuar,Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 "Për rregullat ,procedurat e kërkimit,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënje në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau-Dejes të :

**V E N D O S I**

1. Miratimin e rinovimit të kontratës nr.KK1011 SA,Datë 22.07.2011për dhënie me qira te fondit Pyjor për ngastrën nr .118b Ekonomia pyjore shllak 2 ,me siperfaqe **0.02 ha** për antene për kumunikime elektronike,publike,telefoni celulare, si dhe rrugë kalimi me gjatësi 0.2 km linje elektrike 0.13 km nga Subjektit **"ALBtelekom" sh a,**sipas raportit teknik,relacionit dhe hartës bashkëlidhur.
2. Efektet: Jep impaktë pozitive tek subjekti/komuniteti duke rigjeneruar të ardhura , sigurohen të ardhura tek Bashkia të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.
3. Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas studimit tekniko-ekonomik bashkëlidhur, sipas VKM, Nr. 1064, dt. 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave".

**KRYETARI**

**MARK BABANI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**
**ZV/KRYETAR**
**KRISTIAN SHKRELI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU I DEJËS

*Adresa: Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës, Telefon/Faks 00355 2612 0006. e-mail: info@vaudejes.gov.al*

**Bashkia Vau Dejës** *Shtojca nr. 1*

# R A P O R T

## MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM/HEQJE NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR TË SIPËRFAQEVE NË PRONËSI PUBLIKE TË BASHKISË VAU DEJËS

*RINOVIM KONTRATE TË DHËNIES ME QIRA TE FONDIT PYJOR SUBJEKTIT "ALBTELECOM"* Sh.A, *STACIONI **KK1011** PËR ANTENË TË TELEFONISE CELULARE.*

Bazuar në Urdhërin nr.33 datë 03.02.2020 të kryetarit të bashkise për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore objekt , *rinovim kontratë subjektit "albtelekom"* sh.a, *stacioni **1003 Temal** për vendosjen e antenës të telefonise celulare,*grupi i punës i përbërë nga, Z.Zeqir Ujka dhe Z.Mark Suli, specialist i Menaxhimit të pyjeve, specialist i Administrimit të pyjeve , i cili nga data **13.10.2020** deri në datën **14.10.2020** studioj kërkesën e subjektit(shoqërisë) "ALBtelekom **Sh.a** dhe realizoi verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore objekt i dhënies në përdorim për vendosje Antene të telefonise celulare.

Mbështetur në të dhënat e rregjistrit kadastral pyjor/kullosor sipas VKM nr.433, datë 08.06.2016,i ndryshuar "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive, rezulton që sipërfaqja e kërkuar është 0.02 ha, dhe bën pjese në **ngastrën nr.118 b** në ekonomine pyjore **Shllak 2**,sipas listes së inventarit, **shtojca nr.47** me numër rendor **1128** dhe është në pronësi/administrim të Bashkise Vau Dejës.
Përshkrimi parcelar i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj, pasqyrohen në tabelën 1 dhe 2 të këtij raporti.

Nga verifikimi në terren rezulton kjo gjendje: *(sipas tabelave përkatëse 1 dhe 2 Bashkelidhur).*

Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin e paraqitur nga **Shoqëria "ALBtelekom" Sh.a** , nuk ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit dhe treguesit kryesorë të grumbujve, në ngastrën **nr.118b,ekonominë Pyjore *Shllak 2***, por jepen në përdorim në një afat **5 vjeçar.**

Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim nga fondi pyjor dhe kullosor publik janë të mbështetura në V.K.M-ve nr 1353, datë 10.10.2008, të ndryshuar "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe proçedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", në VKM-ve nr 1374, date 10.10.2008, të ndryshuar

"Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor", në Udhëzimin e Ministrit te Mjedisit nr. 1 datë 9.06.2016 "Për rregullat ,procedurat e kërkimit,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënje në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik",pika 22 germa g.

Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër, shoqëria kryen aktivitetin për sipërfaqen e shpallur, vetëm pas lidhjes së kontratës me bashkinë **Vau Dejës** dhe likujdimit të tarifës prej **133 850 (Njeqind e tridhjete e tre mije e teteqind e pesedhjete)** lekë.

Tarifat e dhënies në përdorim nga fondi pyjor kullosor bazohen në VKM-ve në 1064, date 22.12.2010 "Për disa ndryshime në vendimin numër 391, date 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për percaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave",si dhe bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit. Shuma në lek/vit konsiston në:

**7/6. Vlerën e përdorimit te siperfaqes lek/ha/vit**

Trungishte_____-________ha x ______-___lek =______-_____ lekë

Cungishte____-__________ha x _____-_____lek =______-_____ lekë

Shkurre_______-_________ha x ________-__lek =______-_____lekë

Inproduktive... ha **0.02 x 5 500 000** leke/ha/vit = **110 000** lekë

**12/6 Vlera e përdorimit të rruges km/vit**

Trungishte____-_____km x ____-_____lek =_____-______ lekë

Cungishte_____-____km x ____-_______lek =______-_____lekë

Shkurre_______-____km x _____-_____lek =______-_____lekë

Inproduktive. **0.2 km** rruge auoto x 25 000 leke/km/vit = **5000** lekë

**11/6. Vlera e përdorimit të linjes elektrike në km/vit**

Trungishte____-_____km x ____-_____lek =_____-______ lekë

Cungishte_____-____km x ____-_______lek =______-_____lekë

Shkurre_______-____km x _____-_____lek =______-_____lekë

Inproduktive.**0.13 km** linje elektrike x 145 000 leke/km/vit = **133 850** lekë

Totali leke: **133 850 (Njeqind e tridhjete e tre mije e teteqind e pesedhjete)** lekë.

PËRPILUESIT E RAPORTIT TEKNIKO-EKONOMIK

**Ing.Mark Suli** **Ing.Zeqir Ujka**

**KRYETARI**
**MARK BABANI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**
**ZV/KRYETAR**
**KRISTIAN SHKRELI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU I DEJËS

Bashkia Vau Dejës

## PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR (Sipas regjistrit kadastral)

**Per vendosje antene** **Albtelecom sh.a** **Antena Temal**

| ID. Prones | Ekon.Pyjore | Parc | Perb. grumb | Funksioni | Forma Qeverisjes | Mosha | K.D | Te dhena te grumbullit pyjor D mes | Lart. mes | Filizeria | Nen pylli | Katet | Fuqia lendore per ha | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| SH65 00 118b | Shllak 2 | 118b | Inproduktive | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | | |
| **Gjithsejt** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | | 0 | 0 |

Bashkia Vau Dejës

## PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR ( sipas verifikimit ne terren)

Formulari 1

**Per vendosje antene** Antena Temal

| ID. Prones | Ekon.Pyjore | Parc | Perb. grumb | Funksioni | Forma Qeverisjes | Mosha | Te dhena te grumbullit pyjor K.D | D mes | Lart. mes | Filizeria | Nen pylli | Katet | Fuqia lendore per ha | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| SH65 00 118b | Shllak 2 | 118b | Inproduktive | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | | |
| **Gjithsejt** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | | 0 | 0 |

**PLOTESOI:**

**Ing.Mark Suli** **Ing.Zeqir Ujka**

**Bashkia Vau Dejës**

## TABELA PERMBLEDHESE E VLERESIMIT FINANCIAR

**Antena Temal**

| Perdorimi I territorit | Sip ha | Bashkia | Volumi ne $m^3$ sipas asortimenteve | Volumi ne m3/kv/k | Dhenje ne perdorim lek/ha/vit | | Vlera | Shuma I | Gjatesia e perdorimit ne km | Tarifa dhenje ne perdorim lek/km/vit | | | Shuma II | Totali I+II |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Ha | leke/ha/vit | lek $m^3$ | | | 1 | 2.-5 | 6.-10 | | |
| 0 | 1 | 2 | 3 | | | | 4 | 5 | 6 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 |
| Trungishte | 0 | Vau Dejës | L. punimi | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | Dru zjarri | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Cungishte | 0 | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Shkurre | 0 | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | | 0 | 0 | 0 |
| Kullote | 0 | Vau Dejës | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Inproduktive/shkembore | **0.02** | Vau Dejës | 0 | **0** | **0.02** | **5500000** | 0 | **110 000** | **0.2** | **25 000** | **0** | **0** | **5000** | **115 000** |
| | | | 0 | **0** | **0** | **0** | 0 | 0 | **0.13** | **18850** | **0** | **0** | **18850** | **18850** |
| | | | 0 | **0** | **0** | **0** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Bime med | 0 | | 0 | **0** | **0** | **0** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Gjuetia | 0 | | 0 | **0** | **0** | **0** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Invest | 0 | Vau Dejës | 0 | **0** | **0** | **0** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **Gjithsejt** | **0.02** | | 0 | | **0.02** | **0** | 0 | **110 000** | **0.2** | | **0** | **0** | **23850** | **133 850** |

**PLOTESOI:**

**Ing.Mark Suli** **Ing.Zeqir Ujka** **Esmeraldo Harapi**

Bashkia Vau Dejës

## LISTA E NGASTRAVE TË FONDIT PYOR DHE KULLOSOR PUBLIK QË HIQEN/JEPEN NË PËRDORIM

**Per vendosje antene Temal** **Albtelecom sh.a** **Formulari 5**

| Nr. | ID pones | Ekonomia pyjore/Kullosore | Ng/ n/ngast. | Siperfaqja qe hiqet nga fondi pyjor/ kullosor ha | Siperfaqja totale qe jepet ne perdorim nga fondi pyjor/kullosor ha | Gjatesia ne perdorim km | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Rruge | Linje | Tubacion/ kanal |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 |
| 1 | SH65 00 118b | Shllak 2 | 118b | 0 | 0.02 | 0.2 | 0.13 | 0 |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | SH65 00 118b | Shllak 2 | 118b | 0 | 0.02 | 0.2 | 0.13 | 0 |

**PLOTESOI:**

**Ing.Mark Suli** **Ing.Zeqir Ujka** **Esmeraldo Harapi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**
**DREJTORIA E PYJEVE,TURIZMIT KULTURES DHE MJEDISIT**
**Sektori i Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave**

Nr. 93 prot. Vau Dejës, më 16.10.2020

RELACION

*RINOVIM KONTRATE TË DHËNIES ME QIRA TE FONDIT PYJOR SUBJEKTIT "ALBTELECOM"* Sh.A, *STACIONI* ***1011 Temal*** *PËR ANTENË TË TELEFONISE CELULARE.*

**Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau i Dejës**

**Të nderuar këshilltarë,**

Bashkia **Vau i Dejës,** në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, ndër të cilët është edhe administrimi i pyjeve dhe kullotave vendore sipas mënyrës së përcaktuar me ligj ka në administrimin e saj gjithsej 31 118.2 ha. Pjesë e këtij administrimi është edhe dhënia me qira/përdorim e këtij fondi pyjor nëpërmjet të tretëve.
Kështu kompania **ALBtelekom**" sha , me numer 3810/1 datë 10.07.2020, administruar pranë Bashkisë Vau i Dejës , ka kerkuar rinovimin e Kontratës se Qerasë për përdorimin e fondit pyjor/kullosor , për antenën e komunikimit të telefonisë celulare **ALBtelekom** e ndodhur në Temal,Njësia Admiunistrative Temal, stacioni **nr. KK 1011** me nr.**3120.**
Kontrata e qerasë ( përdorimit) për sipërfaqen pyjore prej 0.02 ha në fshatin Temal e ndodhur në Ekonominë Pyjore Shllak 2, ish Komuna Temal,ka qënë e lidhur me Ish komunen Temal me afat përdorimi 9 vjeçar .

Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar pranë Bashkisë Vau i Dejes/ Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave , rezulton që parcela në të cilën është e ndërtuar kjo antenë komunikimi , ështe pjese e inventarit të pronave të Bashkisë Vau i Dejes , kjo bazuar në në VKM nr. 433 dt 08.06.2016 "i ndryshuar për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të MM e të ish komunave/bashkive", me nr Ngastre 118b dhe bën pjesë në ekonomine pyjore **Shllak 2**,sipas listes së inventarit, **shtojca nr.47** me numër rendor **1128.**
Bazuar në Ligjin nr 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore",neni 9 pika 1.2 c , neni 54 pika el , është kompetencë e Këshillit të Bashkisë ,tjetërsimi apo dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë.

Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 " Për rregullat , procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" , pika 22/g , përjashton nga konkurimi publik dhënien në përdorim të sipërfaqeve për *ndertimin e antenave të komunikimit radiotelevizive dhe telefonisë celulare.*
Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria **ALBtelekom**" sha është konform pikës 22 g të këtij Udhëzimi,pikes 24 dhe përbëhet nga:

a) leja/licenca përkatëse nga institucioni qendror për ushtrimin e veprimtarisë;

b) kontratat ekzistuese të lidhura me autoritetet përkatëse ( ish Komuna Bushat)

c) projektin teknik të zbatimit

d) hartën topografike me kordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në formatin PDF dhe në format elektronik në shkallën 1:10000 ku janë evidentuar elementet kryesore, si: zona kadastrale sipas ZRPP-së, kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, si dhe lidhjen me të dhënat për treguesit kadastralë pyjorë dhe kullosorë;

e) lejen e mjedisit

f) lejen e ndërtimit;

g) aktin e regjistrimit pranë QKR-së.

Bazuar në ligjin nr 57/2020 dt 30.04.2020 "Për pyjet" neni 25 , VKM nr. 1064 date 22.12.2010 "Për disa ndryshime në VKM nr. 391/2006 " Për tarifat në shërbimin pyjor/kullosor i ndryshuar , lidhja 2 pika 7;6 dhe 12:6 në bazë të "përdorimit të territorit" dhe afatit të dhënies në përdorim janë përcaktuar tarifat si më poshtë:

| 7. Për vendosje antene të telefonisë fikse, të lëvizëshme, televizive, radio-komunikimit | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Nr. | Përdorimi i territorit | Siperfaqia e perdorur ne ha | Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit | |
| | | | 1-5 vjet | 6-10 vjet |
| 7:6 | Inproduktive | 0.02 | 5 500 000 | 5 000 000 |
| 12:6 | Inproduktive | 0.2 km rruge | 25 000 | 0 |
| 11:6 | Inproduktive | 0.13 km linje | 145.000 | 110 000 |

**Ne total: 133 850 (Njeqind e tridhjete e tre mije e teteqind e pesedhjete)** lekë.

Nga ana e Sektorit të Administrimit së Pyjeve dhe Kullotave është përgatitur Raport Studimi Tekniko Ekonomik për këto sipërfaqe si edhe tabelat shoqëruese sipas modelit të miratuar në Udhëzimin nr 1 të Ministrit të Mjedisit, me të dhënat kryesore të sipërfaqes objekt përdorimi , hartat topografike me koordinatat , kufijtë si edhe përdorimin e territorit.

Bazuar në sa më sipër propozojmë miratimin e dhënies në përdorim me qera për një afat 1 vjecar, për shfrytëzimin e sipërfaqes me **Bimësi Pyjore** sipas të dhënave të sipërcituara.

Duke ju falenderuar, ju ftojmë në miratimin e projekt vendimit.

**Specialistet**

**Mark Suli** Leonardo Harapi **Zeqir Ujka**

**Miratoi**

**Drejtori**

**RROK FTONI**

*Adresa: Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës, Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail: info@vudejes.gov.al*

ALBtelecom
...me ju të parët!

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - SEKRETARIA - BASHKIA VAU I DEJËS

Tiranë më, 16/7/2020
Nr. 3810/1 Prot

## SHKRESË PËRCJELLËSE

**Lënda:** Mbi plotësimin e dokumentacionit lidhur me kërkesën për lidhje kontrate qiraje dt. 19.06.2020 Nr. 3810 Prot. i Albtelecom sha,
**Drejtuar:** Bashkia Vau i Dejës,
**Për dijeni:** Kryetarit të Bashkisë, Z. Mark Babani,

*I nderuar Z. Babani,*

Referuar kërksesës së dërguar pranë institucionit tuaj, *dt. 19.06.2020 Nr. 3810 Prot. i Albtelecom sha,* mbi lidhjen e një kontratë qiraje në përfundim të kontratës ndërmjet shoqërisë "ALBtelecom" sh.a. dhe **Bashkisë Vau i Dejës, Njësia Administrative Temal,** (kod stacioni antene KK1011), bazuar në nenin 24 të Udhëzimit nr. 01, datë 09.06.2016, lëshuar nga Ministria e Mjedisit "Për rregullat, proçedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", kemi përgatitur dokumentacionin përkatës në origjinal dhe të njëhsuar me origjinalin.

*Bashkëngjitur kësaj shkrese do të gjeni të njëhsuar me origjinalin :*

- *Vendim Nr.06.dt.20.12.2012 për "Leje infrastrukture për ndërtimin e antenave të telefonisë celulare nga kompania Eagle mobile sha, shoqëruar me databazën teknike të stacioneve, njëhsuar me origjinalin dt.01.07.2020 NrRep. 2640 nga notere Ardjana A.Mediu;*
- *Leje mjedisore Nr.2946/8 Prot. dt.25.05.2011"Për veprimtari që kanë ndikim në mjedis" njëhsuar me origjinalin dt.01.07.2020 NrRep. 2640 nga notere Ardjana A.Mediu;*
- *Autorizim individual Nr.2564 dt.11.05.2015 për "Përdorimin e frekuencave të brezit 900 dhe 1800 MHz", njëhsuar me origjinalin dt.01.07.2020 NrRep. 2640 nga notere Ardjana A.Mediu;*
- *Ekstrakt i Rregjistrit tregtar për shoqërinë Albtelecom sha, datë 18.06.2020;*
- *Rilevim topografik për stacionin e antenës KK1011 i azhornuar dt.23.06.2020 1 faqe si dhe materiali ne formatin CD.*

**Me Respekt,**

**Albtelecom sh.a.**
**Drejtor i Grupit të Teknologjisë**

**Vahap YEROGLU**

J61824053N TIRANË ALBtelecom

ALBTELECOM SH.A.
Autostrada Tiranë-Durrës, Km 7, Kashar, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 42200 123 | website: www.albtelecom.al
NIPT: J61824053N | Kodi Fiskal 3898113

eagle

KK1011 SA

REPUBLIKA E SHQIPERISE - SEKRETARIA - BASHKIA VAU I DEJES

**KONTRATE QIRAJE**

Sot me date **22 Korrik 2011** (dy mije e dhjete) lidhet kjo Kontrate qeraje ("**Kontrata**") nga palet si me poshte vijon:

**Komuna Temal**, ne qarkun e Shkodres, perfaqesuar ligjerisht nga Kryetari i Komunes Z. **Mark Zhuri**, i biri i Luigjit, shtetas shqiptar, lindur ne Telume, Shkoder dhe banues ne Temal, Shkoder, me Karte Identiteti numer **024 571 186** , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili ketu e ne vazhdim do te quhet "**Qeradhenesi**"

Dhe

"**Eagle Mobile**" **sh.a.** shoqeri anonime shqiptare, regjistruar si person Juridik ne baze te vendimit te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, Nr. 30436 Akt, Date 24.10.2003, me seli ne adresen Rruga "Murat Toptani", Eurocol Business Center, Kati i 3-te, 8-te, 9-te dhe i 10-te, Tirane, perfaqesuar nga Drejtori i Pergjithshem Z. Orhan Coşkun, i cili perfaqesohet ligjerisht nga Z. **Mernel Beqaraj**, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, ne baze te Prokures se Posacme, Nr. **2367** Rep, Nr. **1312** Kol. date 13.06.2011, hartuar nga Notere Violeta Sulkaj, anetare e Dhomes se Notereve, Tirane i cili ketu e ne vazhdim do te quhet "**Qiramarresi**".

Se bashku referuar si "Palet", individualisht si "Pala";
te cilat, me vullnetin e tyre te lire e te plote nenshkruajne kete Kontrate me kushtet e meposhtme:

Qeradhenesi deklaron se eshte Pronar i Prones prej **1200 m²** (pjese e truallit), e ndodhur ne Kodra e Pylles, Temal, Shkoder, Shqiperi, bazuar ne dokumentacionin ligjor qe eshte i vlefshem ne lidhje me kete prone e cila verteton se Qeradhenesi eshte Pronari i saj.

Qeradhenesi eshte i autorizuar te lidhe kete Kontrate ne baze te Vendimit te Keshillit te Komunes **Temal** Numer **7**, date **22 / 02 / 2011.**

Qeramarresi deklaron se nepermjet kesaj Kontrate do te marre me Qera nga Qeradhenesi **200 m²** (pjese e truallit), e cila eshte Prone e Qeradhenesit dhe qe do te perdoret per interes te Qeramarresit (ketu e ne vazhdim do te quhet "**Prona**"). Brenda siperfaqes se marre me qera dhe pa pagese shtese do te perfshihet edhe rruga e kalimit per tek antena, e cila eshte gjithashtu prone e qeradhenesit.

Prona eshte e ligjshme, e lire nga cdo barre, hipoteke, detyrime apo pretendime dhe jepet me qera aty ku eshte dhe siç eshte. Qeramarresi do te marre me qera dhe do te perdore Pronen sipas qellimeve, afateve dhe kushteve te percaktuara sa me poshte vijon ne kete Kontrate.

Qeramarresi do te marre me qera dhe do te perdore Pronen sipas qellimeve, afateve dhe kushteve te percaktuara sa me poshte vijon ne kete Kontrate.

**Neni 1 Qellimi i kontrates dhe pershkrimi i prones**

1. Qellimi i kesaj kontrate eshte marrja me qera dhe perdorimi i Prones nga Qeramarresi sipas kushteve te percaktuara ne kete Kontrate.

2. Prona do te perdoret nga Qeramarresi dhe/ose nenkontraktoret e tij per te vendosur/implementuar Aparatet Marrese-Dhenese GSM/UMTS dhe pjeset e tyre te cilat do te perdoren nga shoqeria Eagle Mobile sh.a. per ofrimin e sherbimeve te saj qe do te perfshije, por nuk do te kufizohet vetem te aparatet, antena, kulla, kabllo, tela, gjeneratore por edhe ne pajisje ndihmese, paisje per energjine elektrike, bateri, konteniere, skara metalike, shirita togezues, pllaka metalike dhe paisje te tjera te nevojshme dhe qe kane lidhje me implementimin dhe funksionimin e Aparateve Marres-Dhenes GSM/UMTS dhe pjeseve te tyre.

3. Qeradhenesi lejon instalimin e skarave metalike, shiritave togezues, kabllove dhe ndonje pajisje tjeter te nevojshme, mjeteve apo pajisjeve te ndryshme treguese qe perdoren per fushen e tregut dhe per emrin e qeramarresit ne pjesen e fasades se nderteses, ne tarrace dhe/ose ne kolonat vertikale te nderteses si dhe ne prone, nese eshte e nevojshme dhe pjese integrale te pajisjeve GSM/UMTS.

4. Qeradhenesi garanton se ai eshte pronar i vetem ligjor i Prones dhe se Prona eshte e ligjshme, e lire nga cdo barre, hipoteke, detyrime apo pretendime dhe jepet me qera aty ku eshte dhe siç eshte.

5. Planimetria e prones dhe dokumentacioni i Prones eshte pjese integrale e kontrates te cilat i bashkengjiten kontrates si Aneks.

**Neni 2 Pronesia**

1. Qeradhenesi verteton pronesine e Prones se permendur ne kete Kontrate me ane te dokumentacionit ligjor qe eshte i vlefshem ne lidhje me pronesine e tij mbi pronen, i cili nuk eshte fshire, ndryshuar dhe nuk ka shenime te tjera pervec atyre ne interes te Qeramarresit.
2. Dokumentacioni i paraqitur, i cili verteton pronesine e Qeradhenesit mbi Pronen eshte pjese integrale e kontrates dhe i bashkegjitet Kontrates si Aneks.
3. Ne rast se Qeramarresi peson ndonje dem ose humbje per shkak te paleve te treta te cilat pretendojne te jene pronare ose bashkepronare ne nje nga menyrat e parashikuara ne ligj, atehere Qeradhenesi eshte i detyruar te mbaje te pademtuar dhe te demshperbleje Qeramarresin per demin dhe / ose humbjet brenda nje kohe te arsyeshme, por ne cdo rast kjo duhet te behet brenda 2 (dy) muajve nga momenti berjes se njoftimit nga Qeramarresi. Qeramarresi brenda 2 (dy) javeve nga momenti i shkaktimit te demit dhe / ose humbjes, do te plotesoje dhe t'i jape Qeradhenesit nje deklarate te shkruar per humbjet, demet si dhe shpenzimet e tjera te kryera.
4. Ne rast se ka ndryshime ne titullin e pronesise, Qeradhenesi duhet te siguroje dhe garantoje Qeramarresin se kjo kontrate do te vazhdoje te jete e regjistruar dhe do t'i dorezoje Qeramarresit nje deklarate te nenshkruar nga Pronari i ri ku do t'i siguroje se ai do te respektoje kushtet dhe parashikimet e kesaj kontrate.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË SEKRETARIA ... VAU I DEJES

**Neni 1 Qellimi i kontrates dhe pershkrimi i prones**

1. Qellimi i kesaj kontrate eshte marrja me qera dhe perdorimi i Prones nga Qeramarresi sipas kushteve te percaktuara ne kete Kontrate.

2. Prona do te perdoret nga Qeramarresi dhe/ose nenkontraktoret e tij per te vendosur/implementuar Aparatet Marrese-Dhenese GSM/UMTS dhe pjeset e tyre te cilat do te perdoren nga shoqeria Eagle Mobile sh.a. per ofrimin e sherbimeve te saj qe do te perfshije, por nuk do te kufizohet vetem te aparatet, antena, kulla, kabllo, tela, gjeneratore por edhe ne pajisje ndihmese, paisje per energjine elektrike, bateri, konteniere, skara metalike, shirita togezues, pllaka metalike dhe paisje te tjera te nevojshme dhe qe kane lidhje me implementimin dhe funksionimin e Aparateve Marres-Dhenes GSM/UMTS dhe pjeseve te tyre.

3. Qeradhenesi lejon instalimin e skarave metalike, shiritave togezues, kabllove dhe ndonje pajisje tjeter te nevojshme, mjeteve apo pajisjeve te ndryshme treguese qe perdoren per fushen e tregut dhe per emrin e qeramarresit ne pjesen e fasades se nderteses, ne tarrace dhe/ose ne kolonat vertikale te nderteses si dhe ne prone, nese eshte e nevojshme dhe pjese integrale te pajisjeve GSM/UMTS.

4. Qeradhenesi garanton se ai eshte pronar i vetem ligjor i Prones dhe se Prona eshte e ligjshme, e lire nga cdo barre, hipoteke, detyrime apo pretendime dhe jepet me qera aty ku eshte dhe siç eshte.

5. Planimetria e prones dhe dokumentacioni i Prones eshte pjese integrale e kontrates te cilat i bashkengjiten kontrates si Aneks.

**Neni 2 Pronesia**

1. Qeradhenesi verteton pronesine e Prones se permendur ne kete Kontrate me ane te dokumentacionit ligjor qe eshte i vlefshem ne lidhje me pronesine e tij mbi pronen, i cili nuk eshte fshire, ndryshuar dhe nuk ka shenime te tjera pervec atyre ne interes te Qeramarresit.
2. Dokumentacioni i paraqitur, i cili verteton pronesine e Qeradhenesit mbi Pronen eshte pjese integrale e kontrates dhe i bashkegjitet Kontrates si Aneks.
3. Ne rast se Qeramarresi peson ndonje dem ose humbje per shkak te paleve te treta te cilat pretendojne te jene pronare ose bashkepronare ne nje nga menyrat e parashikuara ne ligj, atehere Qeradhenesi eshte i detyruar te mbaje te pademtuar dhe te demshperbleje Qeramarresin per demin dhe / ose humbjet brenda nje kohe te arsyeshme, por ne cdo rast kjo duhet te behet brenda 2 (dy) muajve nga momenti berjes se njoftimit nga Qeramarresi. Qeramarresi brenda 2 (dy) javeve nga momenti i shkaktimit te demit dhe / ose humbjes, do te plotesoje dhe t'i jape Qeradhenesit nje deklarate te shkruar per humbjet, demet si dhe shpenzimet e tjera te kryera.
4. Ne rast se ka ndryshime ne titullin e pronesise, Qeradhenesi duhet te siguroje dhe garantoje Qeramarresin se kjo kontrate do te vazhdoje te jete e regjistruar dhe do t'i dorezoje Qeramarresit nje deklarate te nenshkruar nga Pronari i ri ku do t'i siguroje se ai do te respektoje kushtet dhe parashikimet e kesaj kontrate.

**Neni 3 Kohezgjatja**

1. Kohezgjatja e kontrates do te jete per nje periudhe prej 9 (nente) vjetesh duke filluar nga date **02 Qershor 2011** deri me **01 Qershor 2020** , me te drejte rinovimi ne baze te marreveshjes reciproke te te dyja paleve.

2. Palet mund te bien dakort per nje zgjatje te afatit te kontrates duke bere nje njoftim me shkrim 30 dite perpara dates se perfundimit te kontrates.

**Neni 4 Cmimi dhe termat e pageses**

1. Qeramarresi do te paguaje nje Qera Vjetore ne shumen **300,000 Leke** (Treqindmije), përkundrejt leshimit te faturave perkatese tatimore nga Qiradhenesi per Qiramarresin.

2. Pagesat do te behet njevjecare parapagim. Pagesat do te behet brenda 21 diteve pune qe nga dita e fundit e perfundimit te 12 mujorit te fundit (te meparshem).

3. Pagesa e pare e vitit te pare do te behet brenda **15 Gusht.**

4. Qeradhenesi nuk do te kerkoje asnje pagese para afatit te percaktuar ne Nenin 4, paragrafi 3.

5. Pagesa do te behet ne llogarine bankare te Qeradhenesit ne Shqiperi, si me poshte:

Emri: **Komuna Temal (Dega e Thesarit Shkoder)**
Llogaria Bankare numer. **OL 3412000**
Banka **BKT**
Monedha **Leke**

6. Ne rast se Qeradhenesi ndryshon numrin e llogarise dhe/ose banken, ai duhet te njoftoje me shkrim per nje ndryshim te tille te pakten 30 dite kalendarike para se te behet pagesa. Ne rast te kundert, Qeramarresi do te beje pagesen ne llogarine bankare ekzistuese, ku pagesa do te quhet e bere dhe Qeramarresi nuk do te mbaje asnje pergjegjesi ne lidhje me kete.

7. Ne rast mosmarreveshje apo konflikti mes Qeradhenesit dhe paleve te treta ne lidhje me Pronen dhe / ose pronesine mbi Pronen e dhene me Qera, Qeradhenesi do te kryeje pagesen ne nje llogari te ndare (te veçante) apo ne nje llogari te percaktuar me nje vendim gjykate apo dokument tjeter detyrues ligjor.

8. Ne cdo rast qeradhenesi nuk do te kerkoje ne asnje menyre pergjate afatit kohor te kesaj kontrate ndryshimin e cmimit te qerase.

**Neni 5 Tatimet, taksat, detyrimet**

1. Cmimi i kontrates perfshin te gjitha taksat, tatimet dhe detyrimet qe aplikohen ne baze te legjislacionit shqiptar ne lidhje me Qerane mbi Pronen, objekt i kesaj Kontrate.

2. Qeradhenesi eshte i detyruar te paguaje cdo tatim, takse apo detyrim ligjor ne lidhje me Pronen e tij.

3. Qeradhenesi do t'i leshoje Qeramarresit faturen perkatese per qeradhenien.

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA VAU I DEJES - SEKRETARIA

**Neni 6 Te drejta dhe detyrimet e Qeradhenesit**

**Qeradhenesi:**

1. Do te siguroje gezimin e lire dhe te qete te prones nga Qeramarresi, per 7 dite te javes dhe per 24 ore ne dite.

2. Nuk do te beje asnje ndryshim apo ndertim, vete ose nga te tretet, ne dhe brenda prones qe mund te pengoje, frenoje, veshtiresoje, apo ndikoje sadopak ne aktivitetin e Qeramarresit. Ne rast te ndertimeve apo ndryshimeve, Qeradhenesi do te lajmeroje me shkrim te pakten 3 (tre) muaj perpara dhe duhet te marre miratimin paraprak me shkrim te Qeramarresit para se te procedoje me ndertime, punime apo ndryshime.

3. Nuk do te nderhyje dhe nuk do te perzihet ne Aparatin Marres-Dhenes GSM/UMTS dhe pjeset e tyre, paisjet dhe sistemin e Qeramarresit.

4. Do te lejoje vendosjen e skarave metalike, kabllove tokezues ne fasaden e nderteses, ne tarrace apo ne kolonat vertikale dhe ndonje pajisje tjeter brenda prones, te cilat jane te nevojshme si pjese e Aparatit Marres-Dhenes GSM/UMTS, pjeseve te tyre dhe pajisjeve GSM/UMTS.

5. Do te lejoje Qeramarresin te perdore energjine elektrike derisa Qeramarresi te kete burimin e tij te energjise dhe sahatin mates dhe do te lejoje Qeramarresin qe te vendose burime energjie ne prone. Ne rast mungese apo nderprerje, Qeradhenesi do te furnizoje Qeramarresin me energji nga burime te tjera. Shpenzimet per kete furnizim do te perballohen nga Qeramarresi sipas te dhenave te regjistruara te treguara ne sahatin mates.

6. Do te siguroje hyrjen e lire te Qeramarresit, te punonjesve te tij dhe personave te autorizuar nga Qeramarresi se bashku me mjetet dhe pajisjet perkatese te punes ne Prone.

7. Do te siguroje se nuk do t'i jape te njejtat te drejta njelloj si Qeramarresi te cilat jane pershkruar ne kete kontrate si edhe per kete prone, konkurenteve te Qeramarresit pa miratimim paraprak me shkrim te Qeramarresit.

8. Ne rast se ndonje ligj ne fuqi kerkon aplikimin personal te Qeradhenesit si pronar i Prones, ai do te aplikoje dhe do te mbeshtese Qeramarresin.

9. Ne rast se Qeradhenesi eshte ne dijeni te veprave apo veprimeve te te treteve qe pengojne, veshtiresojne, apo demtojne pajisjet e instaluara te Qeramarresit. atehere ai do te lajmeroje Qeramarresin sa me shpejt te jete e mundur.

**Neni 7 Te drejta dhe detyrimet e Qeramarresit**

**Qeramarresi:**

1. Do te perdore pronen vetem per qellimet e parashikuara ne kontrate
2. Mund te beje ndertime ose ndryshime ne prone per arritjen e qellimeve te kesaj kontrate.
3. Do ta mbaje pronen ne kushte te mira dhe do te beje perpjekjet e tij me te mira per te mos e demtuar.
4. Per shkak te arsyeve teknike dhe/ose azhornimit te nevojave teknike. Qeramarresi ka te drejte te beje ndryshime, restaurime apo shtesa, ne prone, te cilat perfshijne por nuk kufizohen vetem te pajisjet shtese te Radio Link, Seti i gjeneratorit, sisteme. etj. te cilat do te jene brenda kufijve te prones dhe qellimit te kesaj kontrate duke mos paguar asnje qera shtese te Qeradhenesi.
5. Do te jete pergjegjes vetem per ato deme qe jane shkaktuar per shkak te instalimit dhe mirembajtjes te Aparatit Marres-Dhenes GSM/UMTS dhe pjeseve te tij.

**Neni 8 Kalimi i kontrates**

Asnje nga palet nuk do t'a kaloje apo transferoje me asnje forme kete Kontrate apo ndonje nga te drejtat, detyrimet apo angazhimet e saj, tek nje person apo entitet tjeter, pjeserisht apo te teren, pa miratimin paraprak me shkrim te pales tjeter. miratimi i se cilës nuk duhet te vonohet apo refuzohet ne menyre te paarsyeshme.

**Neni 9 Perfundimi i kontrates nga Qeradhenesi**

Qeradhenesi ka te drejte te perfundoje kete kontrate para dates se perfundimit vetem ne rast se:

Qeramarresi nuk ka bere pagesen brenda 3 (tre) muajve duke filluar nga data e fundit qe duhej bere pagesa ashtu si parashikohet ne nenin 4 te kesaj kontrate.

**Neni 10 Perfundimi i kontrates nga Qeramarresi**

1. Qeramarresi ka te drejte te perfundoje kete kontrate perpara dates se perfundimit ne rast se:
   - Qeradhenesi nuk mund te siguroje/garantoje gezimin e lire dhe te qete te prones nga Qeramarresi.
   - Qeradhenesi nuk merr dot leje, miratimi, aprovim nga pushteti dhe /ose agjensite lokale dhe nuk nenshkruan ndonje nga dokumentat ne lidhje me kete kontrate.
   - Qeramarresi eshte i detyruar te largohet nga territori i Republikes se Shqiperise per shkak te luftes, trazirave apo ndonje arsyeje te tille.

- Nje perfundim i tille i kontrates eshte i nevojshem per performacen e aktivitetit te tij.

2. Qeramarresi ka te drejte te perfundoje kete kontrate ne cdo kohe duke bere nje njoftim paraprak me shkrim prej 30 (tridhjete) ditesh. Kjo kontrate përfundon pas 30 diteve kalendarike pas përpilimit te këtij njoftimi noterial.

3. Ne rast te perfundimit te kontrates nga cdonjeri prej Paleve, Qeramarresi do te cmontoje dhe heqe pajisjet e tij brenda 30 (tridhjete) ditesh dhe Qeradhenesi nuk do t'a pengoje apo veshtiresoje Qeramarresin ne asnje forme dhe me asnje mjet.

**Neni 11 E drejta e parablerjes**

Ne rast se Qeradhenesi deshiron te shese pronen ose nje nga pjeset e saj te cilat perbejne pronen, atehere Qeramarresi ka te drejten e parablerjes.

**Neni 12 Ndryshimet**

Ndryshimet ne kushtet dhe termat e Kontrates mund te behen vetem me marrëveshje me shkrim të palëve. Çdo ndryshim i kësaj Kontrate është i vlefshëm vetëm nëse është nënshkruar rregullisht nga të dyja palët dhe vetëm pas nënshkrimit nga palët konsiderohet pjësë përbërëse e kësaj Kontrate. Te gjitha ndryshimet inkorporohen ne Kontrate me marreveshje formale te shkruar.

**Neni 13 Teresia e kontrates**

Kontrata sebashku me te gjitha termat dhe kushtet e saj do te interpretohet si nje e tere. Ne rast te dykuptimesise, paqartesise apo mosperputhjeve, per shkak te ndonje neni, paragrafi apo fraze, do te interpretohet dhe konsiderohet ne kontekstin e te gjithe Kontrates dhe sipas qellimit per te cilin palet kane lidhur kete Kontrate.

**Neni 14 Gjuha e kontrates**

Kjo Kontrate u hartua ne 19 nene, ne 3 (tre) origjinale te perpiluara ne gjuhen Shqipe, dhe do te interpretohet ne gjuhen Shqipe.

**Neni 15 Njoftimet**

Cdo njoftim ose komunikim qe lind si nevoje e zbatimit te kesaj Marreveshjeje, do te dergohet nga njera Pale me poste te regjistruar tek Pala tjeter, sipas adresave te Paleve te percaktuara ne kete Kontrate.

**Neni 16 Konfidencialiteti**

Palet do te mbajne konfidenciale Kontraten dhe permbajtjen e saj. Perjashtohet nga ky rregull vetem kur Kontrata dhe permbajtja e saj kerkohet detyrimisht me ligj t'u behet e njohur organeve kompetente shteterore.

**Neni 17 Ligji i zbatueshem**

Kontrata, lidhja, nenshkrimi, zbatimi dhe interpretimi, si dhe marredheniet midis paleve, rregullohen sipas ligjeve Shqiptare. Te gjitha kushtet e tjera qe nuk trajtohen ne kete Kontrate jane te zbatueshme per palet sipas akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi.

**Neni 18 Zgjidhja e mosmarreveshjeve**

1. Palet do te bejne perpjekjet maksimale qe te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin nga kjo Kontrate, zbatimi dhe interpretimi i saj, te zgjidhen me mirekuptim. Ne te kundert, per te gjitha mosmarreveshjet qe rrjedhin apo jane ne lidhje me kete Kontrate, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata perkatese.

2. Nese palet bien dakort, me deshiren e tyre mund t'i drejtohen Arbitrazhit.

**Neni 19 Dispozita te fundit**

Kjo kontrate do te hyje ne fuqi ne diten e nenshkrimit nga palet, pas se ciles Qeramarresi mund te filloje instalimin e paisjeve, kurse pagesat do te behen ne perputhje me nenin 4 te kesaj Kontrate.

**Per dhe ne emer te Qeradhenesit**

Komuna Temal

Kryetari

**Mark Zhuri**

**Per dhe ne emer te Qeramarresit**

Per Eagle Mobile sh.a.

**Mernel Beqaraj**

Mernel Beqaraj

Azhonuar dt. 23.06.2020.

Koordinatat jane ne sistemin UTM Zone 34N







*PERGATITI*

STUDIO " BYLIS HOLDING "

PROJEKTIM -KONSTRUKSION - TOPOGRAFI

LICENCE: T.0659/1 04 / 09 / 2019

KATEGORIA 8/b

DATA E PERGATITJES 23 / 06 / 2020

Studio "BYLIS HOLDING"
Top. GJERGJI BEGA
Nr.Liç. T.0659/1

Legjendë

| | |
|---|---|
| ▭ | antene |
| — | rruge |

# *Rilevim Topografik*

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA VAU I DEJES - SEKRETARIA




*IDENTIFIKIMI I PASURISE:*

Zona Kadastrale :
Numri i pasurise :
Indeksi i hartes : K-34-64-(186-B)

*Koordinatat e siperfaqes qe zë Antena KK1011.*

| | Y | X |
|---|---|---|
| 1 | 4661401.0560 | 400863.4605 |
| 2 | 4661398.0343 | 400868.9587 |
| 3 | 4661389.6251 | 400864.3373 |
| 4 | 4661392.6467 | 400858.8391 |

*ADRESA: Vau-Dejes, Temal*
*POROSITESI: ALBTELECOM SH.A*

| | | |
|---|---|---|
| ▭ | *Sip. Antenes* | *= 60. m2* |
| — | *Gjat. e Rruges* | *= 80.7 m* |

*SH 1:500*